

STATUTI

I

SHOQËRISË

Geghyseni sh.p.k

KREU I

KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA dhe KOHËZGJATJA e SHOQËRISË.

KREU I

Neni 1

PJESA E PERGJITHSHME

Sipas kerkesave te ligjit Nr.9901,date.14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare",ligjit Nr.9723,dt.03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",krijohet shoqeria tregetare **Geghyseni** shpk e cila do te veproj ne perputhje me legjislacionin shqiptare ne fuqi,nenet e ketij statusi dhe akt themelimin bashkangjitur.

KREU II

Neni 2

Forma e shoqërisë

1.Shoqëria me pergjegjësi të kufizuar **Geghyseni** sh.p.k. me seli në ,**Lagjja Dardania,Rruga Beselidhja e Malesise,Zona Kadastrale Nr.1347, Nr.Pasurie 11/36-N3**, është krijuar sipas Akt-Themelimit që i bashkëngjitet këtij Statuti, i hartuar dhe i nënshkruar nga ORTAKU:

1. **Ylber Geghyseni i biri i Veli-ut datelindjes.02-03-1980, lindur e banues ne Bajram Curri i paisur me leternjoftim me Nr.I00302122E.**

NENI 3

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoj humbje deri ne kufirin e kontributit themelues te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 4

Selia e shoqërisë

1.Selia e shoqërisë është ne , **Lagjja Dardania,Rruga Beselidhja e Malesise,Zona Kadastrale Nr.1347, Nr.Pasurie 11/36-N3.**

2. Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në Shqipëri dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e këtij Statuti. Shoqëria mund të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e RSH dhe të vendit të huaj ku ajo mund të ngrejë filial.

Neni 5

Identifikimi i shoqërisë

1. Shoqëria e fiton personalitetin juridik nga dita e regjistrimit të saj në qendren kombetare te regjistrimit..
2. Shoqëria ka vulën e vet dhe emrin e saj të identifikueshëm në çdo akt të lëshuar prej saj.

Neni 6

Emertimi i shoqërisë

Emërtimi i plotë i shoqërisë është **Geghyseni** sh.p.k.

KREU III

Neni 7

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Objekti i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë **Geghyseni** sh.p.k. është sa më poshte vijon:

Bar-Restorant.Import-Eksport.Makina me qera.Shitje dhe blerje automjeteve të reja dhe të përdorura.

Neni 8

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë, do të jetë pa afat të caktuar.

Neni 9

Përfaqsimi i Shoqërisë

1. Administratore të shoqërisë **Geghyseni** sh.p.k. do të jetë z.**Ylber Geghyseni** me afat 5-vjeçarë me të drejtë rizgjidhje.



2. Nga ana ligjore shoqëria ndaj palëve të treta përfaqësohet nga ortaku dhe administratoret e saj **Ylber Geghyseni**, duke ushtruar kompetencat e plota që parashikohen sipas këtij Statuti.

KREU IV

Neni 10

Kapitali themeltar

1. **Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) LEKË. Ai është i ndarë në 1 kuote.**
2. **Ylber Geghyseni** i zoteron 100 % te kuotave.

Neni 10/1

Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Neni 11

Pasojat e kalimit të kuotave

1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni.
2. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Neni 12



Pjesëtimi i kuotave dhe transferimi i tyre

1. Me përjashtim të rasteve kur kjo është e ndaluar nga statuti, kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.
2. Dispozitat e nenit 73 të këtij ligji për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

Neni 13 Organet drejtuese

Organi vendimor i shoqërisë është ortakët
Ortaku i vetëm ke të gjitha të drejtat që ka Asambleja e ortakëve.
Ortaku i vetëm vendos për çështje të tilla si emrimi ose shkarkimi i
administratoreve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likujdueseve, miratimi i raporteve të
administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndaria e fitimit, ndryshimet në
status, zvogëlimi ose zmadhimi i kapitalit themelor, transferimi i pjesëve të kapitalit themelor
të të tretet, zgjatja e afatit të veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shenderimi i
shoqërisë në një formë tjetër në një nga format e parashikuara nga ligji, ndyshimin i
vendqendrimit të selisë.

KREU V

Neni 14 Kontrolli i Shoqërisë

Kontrolli i Shoqërisë bëhet nga një Ekspert Kontabël, i cili emërohet dhe shkarkohet nga
Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm), në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, dt.
14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

KREU VI VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE dhe NDARJA E FITIMIT

Neni 15 Viti financiar

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar, ora 00^{oo} dhe përfundon me 31 Dhjetor, ora 24^{oo}.
Përjashtimisht viti i parë financiar fillon ditën e regjistrimit si person juridik në rregjistrin
tregtar.

Neni 16

Llogaritë vjetore, inventari, raporti mbi veprimtarinë e vitit financiar të hartuara nga
Financieri, i nënshtrohen miratimit të Asamblesë së Ortakëve (ortakët), brenda afatit prej 3 muajve
nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 17



Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

Neni 18

Shpërndarja e fitimeve të shoqërisë

1. Mënyra e përdorimit të fitimit të Shoqërisë do të vendoset nga Ortaket.
2. Llogaritja e fitimit dhe e humbjes me qëllimin e bërjes së deklaratave financiare duhet bërë në bazë të rregulloreve në fuqi mbi standartet llogaritare. Nëse Shoqëria realizon fitim sipas rregullave dhe rregulloreve që parashikojnë shpërndarjen e dividendit, çdo tepricë pas pagesës së taksave të saj ("Teprica") mbetet pronë e Shoqërisë dhe Shoqëria mund ta përdorë atë sipas vendimit të ortakut të vetem.

Neni 19

Shoqëria ka të drejtën e përdorimit lirisht të fitimeve dhe të disponimit lirisht të pasurisë së saj, në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që kryen.

Neni 20

Detyrimet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, ajo i mbulon nga Kapitali Themeltar i shtuar ose nga shumat suplementare.

Neni 21

Shoqëria gëzon të gjitha të drejtat dhe mbrotjen e pasurive të saj nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

KREU VII

PUNËSIMET NË SHOQËRI.

Neni 22

Rregullimi ligjor i marrëdhënieve të punës

Për punonjësit që do të punësohen në shoqëri, marrëdhëniet juridike midis shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratave individuale të punës, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës të RSH dhe legjislacionit në fuqi që parashikon të drejtën e të punëmarrësve për sigurimin e tyre, në institucionet kompetente private apo publike.

Neni 23

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes,per shkelie disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit por gjithmone duke respektuar afatet qe parashikon Kodi i Punes.

Neni 24



Shoqëria mund të lidh kontrata me sektore shtetëror, drejtperdrejt me tregun e lire si dhe me persona juridik, vendas ose të huaj.

Në veprimet kontraktuale Shoqëria përfaqësohet nga ortaku i vetëm i saj ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij me prokurë.

Te drejtat e detyrimit që rrjedhin nga kontrata janë të detyrueshme për shoqërinë.

KREU VIII

Neni 25

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar priset:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Neni 26

Regjistrimi i shpërbërjes

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Nëse

prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë

3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

Neni 27

Likuidimi në gjendjen e aftësisë pague

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagues.



KREU IX
ZGJIDHJA e MOSMARRËVESHJEVE

Neni 28

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise do te zgjidhen me mirkuptim Nëse nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë atëherë kompetente për zgjidhjen e konflikteve do të jetë Gjykata .

KREU X

DISPOZITA REFERUESE

Neni 29

Për çfarë nuk është parashikuar në këtë Statut, ortakët(ortaku), punonjësit si dhe të tretët që janë të lidhur në marrëdhënie juridike e tregtare me Shoqërinë, do t'i referohen legjislacionit shqiptar që rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Ky Statut u hartua, në Kukës, sot më dt.**21/07/2021**, në bazë të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit Nr.9723, dt.03/07/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit”, Kodit Civil te RSH si dhe Ligjit “Për Falimentimin”, me nr.9919, dt.19.05.2008, dhe hyn në fuqi në ditën e rregjistrimit të shoqërisë në Rregjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit – Dega Kukës.

PËR SHOQËRINË

Geghyseni sh.p.k

ADMINISTRATOR

Ortaku

Ylber Geghyseni



AKT-THEMELIM
I
SHOQËRISË

Geghyseni sh.p.k.

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901,dt. 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”,
UNE, :

- 1. Ylber Geghyseni i biri i Veli-ut datelindjes.02-03-1980, lindur e banues ne Bajram Curri i paisur me leternjoftim me Nr.I00302122E.**

Sot me dt. 21/07/2021, me vullnetin tim të lirë dhe të plotë, vendosa të hartojë këtë **Akt-Themelimi** për krijimin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **Geghyseni sh.p.k.** si

ORTAKET.

Akti i Themelimit hartohet me këto kushte:

Neni 1

Ortaku , me gjeneralitetet e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë krijoj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar **Geghyseni sh.p.k.** .

Neni 2

Shoqëria vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shoqërive tregtare dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i bashkëlidhet këtij Akt – Themelimi.

Neni 3

Emri i plotë i shoqërisë është **Geghyseni sh.p.k.** .

Neni 4

Selia e shoqërisë është në , **Lagjja Dardania,Rruga Beselidhja e Malesise,Zona Kadastrale Nr.1347, Nr.Pasurie 11/36-N3** . Sipas dispozitave të përcaktuara në Statut dhe në



Akt – Themelimit, veprimtaria e shoqërisë do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj, duke krijuar filialet apo degët e saj.

Neni 5

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar **Geghyseni** sh.p.k. do të jetë ai i përcaktuar në Statutin e Shoqërisë :

Bar-Restorant.Import-Eksport.Makina me qera.Shitje dhe blerje automjesh te reja dhe te perdorura.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë **100.000 (njqind mije) leke** ndare ne 1 kuote . Kapitali themeltar mund të rritet sipas dëshirës së ortakeve dhe kushteve në të cilat ushtron veprimtarinë, në formën dhe mënyrën e parashikuar në Statut.

Neni 7

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z.Ylber Geghyseni dhe** kompetencat e tij përcaktohen në Statut.

Neni 8

Viti financiar i Shoqërisë mbyllet me 31 Dhjetor, ora 24^{oo} te çdo viti kalendarik. Bilanci vjetor i veprimtarisë së shoqërisë përfundohet brenda muajit Mars të vitit të pasardhës.

Neni 9

Shoqëria gëzon lirisht pronat dhe mjetet e saj financiare dhe ka të drejtë ti përdorë ato në përputhje me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqërisë.

Neni 10

Ky Akt–Themelim do të jetë efektiv nga dita e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.
Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Për Shoqërinë
Geghyseni shpk

ADMINISTRATORI
Ortaku

Ylber Geghyseni

